



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

#### Senati Akademik

Nr. 318 Prot

Shkodër, më 29. 01. 2018

### **RELACION**

#### *Mbledhja e Senatit Akademik e datës 29.01.2018.*

Senati Akademik (SA) i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", trajtoi disa çështje të rëndësishme në mbledhjen e tij të datës 29.01.2018 dhe morri vendimet përkatëse të mëposhtme:

1. Miratimin e Raportit të veprimtarisë financiare të USH për vitin 2018, në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni nr.38 pika 1/g; ligjit nr.9936/2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH" (i ndryshuar); Ligjit nr.10296/2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; Ligjin 109/2017 "Për buxhetin e vitit 2018"; Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të miratimit të buxhetit".

Miratimi unanim i këtij Raporti nga anëtarët e SA pjesmarrës në këtë mbledhje u arrit pasi senatorët ishin njohur paraprakisht me materialin për këtë çështje dhe pas relatimit për këtë që bëri kryetarja e Drejtorisë së financë- buxhetit. Kjo e fundit së bashku me Rektorin vunë në dukje disa faktorë që kanë ndikuar në veprimtarinë financiare gjatë 2017 si: mungesa e administratorit të ri dhe kompetencave të limituara të veprimit të administratorës së komanduar; dalja e akteve ligjore për pezullimin e përkohshëm të procedurave të prokurorit, mos plotësimi i vendeve për personel akademik të brendshëm (detyrë kjo e lënë edhe në raportin e akreditimit) në mënyrë që të zvogëlohet numëri i pedagogve të jashtëm që paguhën me të ardhurat tona dhe të rritet cilësia e procesit mësimor dhe e kërkimit shkencor; realizimi i kontratës për Ndërtimin e Godinës së re të Fakultetit Ekonomik si një nga investimet më të mëdha që ka bërë USH; mbajtja e kuotave të studentëve në nivel të qëndrueshëm ka ndikuar në patjen e të ardhurave të qëndrueshme; ndikimi në përmirsimin infrastrukturës dhe procesit të mësimdhënies kanë patur projektet në USH me financime të huaja e sidomos Fakulteti Ekonomik. U kërkua nga Senatorët që raporti mbi veprimtarinë financiare të USH të silltet më analitik, me një analizë që mund të kuptohet jo vetëm nga ekonomistët, t'i referohet si ka ndikuar kjo veprimtari në realizimin e objektivave të strategjisë së USH, të bëhet një analize historike e treguesve financiare, të jetë një analize financiare edhe sipas fakulteteve në zërat financiar që janë të mundur; të shtohet numri i pedagogve të brendshëm për 2018; të përfundojë mobilimi i Godinës së re të FE deri në



Shtator 2018; të shikohen burimet e shtimit të të ardhurave dytësore sic është hapja e Shkollës pasuniversitare të drejtorëve të së nesërme; të pasqyrohen on-line raportet e auditimit të jashtëm e të brendshëm për USH. Kryetarja e Drejtorisë së financë-buxhetit i kërkoj SA shtim me një punonjës tek kjo drejtori për të përballuar shtimin e punës ndër vite dhe për të bërë analiza më të thella financiare. Kjo kërkesë u pranua nga anëtarët e SA.

2. Miratimin e strukturës organizative dhe analitike të USH për tremujorin e parë të vitit 2018, në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

U ra dakort unanimitisht nga SA që për tremujorin e parë të vitit 2018 të mbahet struktura organizative dhe analitike e USH njësoj si në vitin 2016.

U la detyrë nga SA që të bëhet nga Komisioni i burimeve njerzore të SA së USH një studim i detajuar dhe të përgaditet draft-propozimi për strukturën organizative dhe analitike të USH që do të jetë pas tremujorit të parë të vitit 2018 dhe të paraqitet për diskutim në mbledhjen e radhës së SA.

Gjithashtu u la detyrë që Komisioni i rregullorë të SA të punojë mbi draft-rregulloren e organizimit dhe funksionimit të SA dhe të sjellë propozimin e tyre për këtë rregullorë në mbledhjen e radhës së SA.

Relacionit i bashkangjiten vendimet e mësipërme të SA për këtë mbledhje.

Relacioni mbi mbledhjen e Senatit Akademik të USH-së të datës 29.01.2018 do të pasqyrohet në website të USH-së.

**Sekretare e Senatit**

**Prof. as., dr. Mirjam Dibra**

**Kryetari i Senatit**



**Prof. dr. Adem Bekteshi**